

# Dëshmia “MUHAMMEDUN RESULULLAH”

مُحَمَّدٌ رَسُولُ اللَّهِ



Designed by: www.eife.at

## Domethënia e saj:

Vërtetim i plotë nga thellësia e zemrës, i cili përputhet me fjalët që i shqipton gjuha, se Muhamedi është rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij tek të gjitha krijesat; njerëzit dhe xhinët.

## Shtyllat e kësaj dëshmie:

1

Pranimi se Muhamedi (ﷺ) është i dërguar i Allahut.  
Argument për këtë është thënia e Allahut:

﴿مُحَمَّدٌ رَسُولُ اللَّهِ﴾

(Muhamedi është i Dërguar i Allahut.)<sup>1</sup>

2

Besimi se Muhamedi (ﷺ) është rob i Allahut.  
Argument për këtë është thënia e Allahut:

﴿وَأَنَّهُ لَمَّا قَامَ عَبْدُ اللَّهِ يَدْعُوهُ كَادُوا يَكُونُونَ عَلَيْهِ لِبَدًا﴾

(Kur rob i Allahut (Muhamedi), u ngrit t'i lutej Atij, ata (xhinët) u tubuan rreth tij si shtëllungë.)<sup>2</sup>

Pra, ai është i dërguar që nuk përgënjeshtrohet dhe rob që nuk adhurohet.

## Kushtet e kësaj dëshmie:

1. Vërtetimi i çdo gjëje për të cilën na ka lajmëruar Muhamedi (ﷺ).
2. Bindja ndaj urdhrave të tij.
3. Shmangia nga ajo prej së cilës na ka ndaluar.
4. Adhurimi i Allahut vetëm në mënyrën që ai e ka ligjësuar.

<sup>1</sup> Sureja el-fet'h, 29.

<sup>2</sup> Sureja el-xhinn, 19.